

Emri i Lëndës : E Drejta e Detyrimeve I							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 305	B	Vjeshtë	3.00	1.00	0.00	3.50	6.00
Lektori		Ada Güven, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program i Integruar					
Përshkrimi		Fokusi i kësaj lënde është njohja me konceptet bazë të detyrimeve dhe kontratave duke u mbështetur në dispozitat e Kodit Civil duke filluar nga neni 419 deri në nenin 1161, si dhe ligje të tjera që kanë lidhje me detyrimet në përgjithësi apo me lloje të vecanta kontratash. Lënda e drejta e detyrimeve zhvillon më tej njohurinë e kandidatëve në fushën e Detyrimeve dhe parashtron pyetjet si përse premtimet janë zbatuar si kontrata, cilat premtime zbatohen, dhe se si ato zbatohen në marrëdhëniet e përditshme tregtare. Lënda shqyrton çështjet kryesore ligjore që prekin institutet e të drejtës së detyrimeve. Këto çështje përfshijnë pyetjet lidhur se kur një kontratë të bëhet e detyrueshme, çfarë personash fitojnë të drejtat sipas një kontrate, kushtet nën të cilat kërkohet garancia, shkelja e kushteve të kontratës dhe mjetet juridike në dispozicion në rast të shkeljes së kontratës. Studentët do të njihen me çështjet e shpërblimit të dëmit, pasurimit të pabazë, gjerimit të punëve të huaja pa porosi, shprehjen e njëanshme të vullnetit. Lënda do të ketë të integruar dhe diskutime dhe debate në klasë lidhur me temat specifike kontemporane të lidhura me të drejtën e detyrimeve.					
Objektivat		Lënda synon që studenti të njihet me konceptet bazë të detyrimeve dhe kontratave, përdorimin e metodave koherente në zgjidhjen e problemeve në fushën e detyrimeve. Studentët do të fokusohen me kushtet e lidhjes së kontratës, me nocionet e dëmit kontraktor dhe dëmin jashtë kontraktor. Nëpërmjet seminareve të integruara me leksionet, debateve dhe diskutimeve në klasë studentët do të mund të prekin nga afër temat më të rëndësishme të lëndës.					
Konceptet Kryesore		1 marrëdhënia juridike e detyrimit 2 propozimi, oferta, refuzimi, lidhja e kontratës 3 kontrata të njëanshme dhe të dyanshme, formale dhe joformale, konsensuale dhe reale 4 Cedimi, 5 Përbushja e detyrimeve, fillimi, mbarimi dhe shuarja e detyrimit 6 Përgjegjësia civile kontraktore dhe jashtëkontraktore					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Kuptimi, objekti, parimet, karakteristikat, dhe burimet e së drejtës së detyrimeve. Lidhja dhe dallimet e saj me degët e tjera të së drejtës Pjesa e Përgjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 15-24						
2	Kuptimi i detyrimit si një marrëdhënie e rëndësishme juridike dhe elementet e tij Pjesa e Përgjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 29-37						
3	Kuptimi i kontratës, mënyra e interpretimit të një kontrate, mënyra e hartimit të saj, kushtet e domosdoshme që duhet të jenë në përmbajtjen e një kontrate si dhe kushtet e tjera, kushtet që një kontratë të jetë e vlefshme, zgjidhja dhe heqja dore prej kontratës si dhe pasojat që vijnë prej tyre.”Pjesa e Përgjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 39-73						
4	Mënyra e lidhjes së një kontrate, fazat kryesore në të cilat kalon lidhja e saj, casti kur një kontratë do të quhet e lidhur, ndryshimi i propozimit për lidhjen e një kontrate nga reklama, nga traktativat tregëtare, nga premtimi i njëanshem, etj.Pjesa e Përgjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 77-94						

5	Llojet kryesore të kontratave dhe grupimi i tyre sipas kriterëve të caktuara në kontrata të njëanshme dhe të dyanshme, formale dhe joformale, konsensuale dhe reale, etj Pjesa e Pergjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 97-103
6	Llojet e detyrimeve ku krahas detyrimeve të thjeshta, alternative, kumulative trajtohen edhe detyrimet me shumë persona, siç janë ato solidare, të pjesetueshme e të papjesetueshme. Pjesa e Pergjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 105-116
7	Ndërrimi i personave në një detyrim. Cedimi i kredisë dhe marrja përsipër e detyrimeve. Kushtet dhe pasojat juridike të realizimit të tyre Pjesa e Pergjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 119-124-116
8	Midterm Exam
9	Mënyra e përmbushjes së detyrimeve në afatin, sasinë, cilësinë dhe vendin e duhur, mënyra e përmbushjes së detyrimeve në të holla. Pjesa e Pergjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 127-140
10	Mospërmbushja e detyrimeve dhe pasojat që vijnë prej saj, vonesa e debitorit dhe e kreditorit në përmbushje Pjesa e Pergjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 143- 151
11	Mënyrat e mbarimit dhe të shuarjes së një detyrimi, kompensimi, përtëritja, konfondimi, etj.”. Pjesa e Pergjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 193-199
12	Faji si kusht i përgjegjësisë civile kontraktore dhe jashtëkontraktore dhe humbjet që duhet të shpërblehen Pjesa e Pergjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 153-161
13	Mjetet e sigurimit të përmbushjes së detyrimeve, kushti penal, pengi, hipoteka, kapari, dorezania Pjesa e Pergjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 163-190
14	Shkaktimi i demit dhe mënyra e shpërblimit të tij. Demi pasuror dhe demi jopasuror, demi i shkaktuar nga kafshet dhe nga sende apo pajisje të rrezikshme, demi i shkaktuar nga tregtimi i produkteve, demi i shkaktuar nga prodhuesi i një malli, nga furnizuesi apo tregetuesi i tij, demi i shkaktuar nga perfaqësuesi, nga nxënësi që meson një mjeshtër, demi i shkaktuar shendetit dhe jetesë së një personi, demi i shkaktuar nga të miturit Pjesa e Pergjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 201-224
15	Begatimi pa shkak, llojet e tij dhe kushtet që të ekzistojë ai Pjesa e Pergjithshme Mariana Tutulani- Semini (2016) E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Skanderbeg Books, Tirane, fq. 227-231
16	Final Exam
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
Referenca të tjera	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të mund të pajisen me njohuritë bazë rreth legjislacionit mbi të drejtën e detyrimeve
2	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të mund të pajisen me njohuritë bazë shkaktimit të demit dhe mënyra e shpërblimit të tij
3	Studentët do të formojnë shprehje mbi burimet e ndryshme të ligjit dhe të jenë në gjendje për të sintetizuar burime të tilla dhe t'i përdorë ato për kërkimet në fushën e drejtësisë

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	15	15
Provimi final	1	25	25
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			146
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.84
ECTS			6.00